



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

UDHËZIME PËR APLIKIMIN PËR VENDIN E LIRË TË PUNËS PRANË AKPT-SË

Ku dorëzohet aplikimi?

Aplikimi bëhet duke dërguar listën e dokumentacionit të kërkuar në adresën e e-mailit:

info@planifikimi.gov.al

E-maili duhet të mbajë titullin: **Aplikim pune për pozicionin (titulli i pozicionit sipas përshkrimit në njoftim)**

Cilat janë dokumentet e nevojshme për aplikim?

Bashkëlidhur e-mailit të aplikimit duhet të dorëzoni dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi i përditësuar, i cili duhet të përmbajë patjetër:
 - Foto të kohëve të fundit;
 - Numër kontakti
 - adresën e plotë të vendbanimit;
3. Kopje e diplomës.
Nëse disponon një diplomë lëshuar nga një universitet i huaj, ajo duhet të jetë e njehsuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsim, apo të jetë bërë aplikimi përkatës;
4. Kopje e listës së notave;
5. Kopje e Librezës së Punës e plotësuar;
6. Çertifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
7. Letër Rekomandimi nga 2 punëdhënësit e fundit;
8. Fotokopje Letërnjoftimi.

Cilat janë hapat që ndiqen nga aplikimi deri në fillimin e punës?

- Brenda 10 ditëve nga mbyllja e afatit të aplikimit, kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në dokumentin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës, do të ftohen për intervistë pranë AKPT-së.
- Brenda 10 ditëve nga zhvillimi i intervistës kandidatët e intervistuar do të njoftohen për vlerësimin e komisionit.
- Kandidati i përzgjedhur do të ftohet për lidhjen e kontratës dhe dorëzimin e dokumenteve të dosjes së noterizuara.
- Me nënshkrimin e kontratës fillon puna në pozicionin e kërkuar, ose në kushtet kur kandidati i përzgjedhur duhet të përfundojë afatin e njoftimit të largimit nga një vend pune tjetër, fillimi në pozicionin e punës bëhet në një afat të dakortësuar mes palëve.